

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar  
Financial Reporting

**P5**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 23.09.2017

## CONTENT / PËRMBAJTJA

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i Dhënë</b>	<b>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</b>
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
<b>Totali</b>	<b>100</b>	

## Problemi 1

Adam sh.a bleu 80% të aksioneve të zakonshme të Smith sh.a për €168 milion në para me 1 janar 2016. Draft pasqyrat e pozitës financiare të këtyre dy kompanive me 31 dhjetor 2016 janë paraqitur më poshtë:

	Adam sh.a		Smith sh.a	
	€m	€m	€m	€m
<b>Pasuritë jo-qarkulluese</b>				
Prona, fabrika dhe paisjet		610		152
Kostot e zhvillimit (shënim iii)		-		28
Investimet		<u>240</u>		<u>10</u>
		<b>850</b>		<b>190</b>
<b>Pasuritë qarkulluese</b>				
Stoqet	105		45	
Të arkëtueshmet tregtare	60		30	
Banka	<u>-</u>	<u>165</u>	<u>8</u>	<u>83</u>
<b>Total pasuritë</b>		<b>1,015</b>		<b>273</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>				
<b>Ekuiteti</b>				
Aksionet e zakonshme prej €1 secila		500		60
Fitimet e mbajtura		<u>222</u>		<u>126</u>
		<b>722</b>		<b>186</b>
<b>Detyrimet afatgjata</b>				
12% notë krediti		205		60
<b>Detyrimet afatshkurtera</b>				
Të pagueshmet tregtare	60		18	
Tatimi	21		9	
Mbiterheqja bankare	<u>7</u>	<u>88</u>	<u>-</u>	<u>27</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>1,015</b>		<b>273</b>

### **Informatat në vijim janë të rëndësishme:**

- i) Fitimet e mbajtura të Smith sh.a me 1 janar 2016 ishin €94 milion. Kapitali aksionar në atë datë ishte €60 milion.
- ii) Adam sh.a ka një politikë të rivlerësimit të tokës dhe ndërtesave. Në datën e blerjes, toka e Smith sh.a kishin vlerë të drejtë prej €20 milion më të lartë se vlera bartëse e saj.
- iii) Një projekt i zhvillimit i Smith sh.a është përfunduar me 31 dhjetor 2015 me një kosto prej €35 milion. €7 milion e kësaj shume është amortizuar në vitin 2016. Drejtorët e Adam sh.a nuk pajtohen me politikën e kapitalizimit të adoptuar nga Smith sh.a dhe janë të mendimit që €12 milion prej pjeses së mbetur të kostove të zhvillimit me 31 dhjetor 2016 nuk përmbushin kriteret e SNK 38 *Pasuritë e paprekshme* për tu njohur si pasuri.

- iv) Smith sh.a shiti mallra tek Adam sh.a gjate vitit me një fitim prej €9 milion. Një e treta e këtyre mallrave është ende në stoqet e Adam sh.a me 31 dhjetor 2016.
- v) Gjatë nëntorit 2016, Adam sh.a i huazoi Smith sh.a-së €10 milion (pa interes) e cila duhet të paguhet në mars 2017. Shumat janë të përfshira në të pagueshmet tregtare dhe të arkëtueshmet tregtare të kompanive përkatëse.
- vi) Një çek prej €8 milion nga Adam sh.a që është dërguar tek Smith sh.a para përfudimit të vitit financiar nuk është pranuar deri në janar 2017.
- vii) Draft pasqyrat financiare të Adam sh.a me 31 dhjetor 2016 përmbanin një shënim që shpjegonte një pasuri kontigjente prej €300,000. Shuma është pranuar me 31 janar 2017 dhe tani duhet të kontabilizohet si një ngjarje korigjuese pas periudhës raportuese.
- viii) Gjatë llogaritjes së zërit të mirë, është politikë e Adam sh.a të vlerësoj interesin jo-kontrollues duke përdorur vlerën e drejtë në datën e blerjes. Në këtë datë, vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues ishte €42 milion.

**Kërkohet:**

- (a) **Përgadite pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare për Adam sh.a me 31 dhjetor 2016.** (17 pikë)
- (b) **Shpjego pse vlerat e drejta të pasurive të një entiteti përdoren në përgaditjen e pasqyrave financiare të konsoliduara.** (3 pikë)

(20 pikë)

## Zgjidhja e Problemit 1

1.

### Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare të grupit Adam me 31 dhjetor 2016

	€m	€m
<b>Pasuritë</b>		
<b>Pasuritë jo-qarkulluese</b>		
Prona, fabrika dhe pajisjet (610+152+20)		782
Kostot e zhvillimit (28-12)		16
Investimet (72+10)		82
Zëri i mirë (L1.3)		<u>36</u>
		916
<b>Pasuritë qarkulluese</b>		
Stoqet (105+45-3)	147	
Të arkëtueshmet tregtare (60+30-8-10)	72	
Të arkëtueshmet tjera	0.3	
Banka (8+8)	<u>16</u>	<u>235.30</u>
		<b>1,151.30</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>		
Aksionet e zakonshme		500.00
Fitimet e mbajtura (L1.5)		<u>235.90</u>
		735.90
Interesi jo-kontrollues (L1.4)		<u>45.40</u>
		781.30
<b>Detyrimet afatgjata</b>		
12% notë krediti (205+60)		265
<b>Detyrimet afatshkurtera</b>		
Të pagueshmet tregtare (60+18-10)	68	
Tatimi (21+9)	30	
Mbiterheqja bankare	<u>7</u>	<u>105</u>
		<b>1,151.30</b>

### L11 Struktura e grupit

Adam



1 janar 2016

Smith

**L1.2 Neto pasuritë sipas vlerës së drejtë**

	Në blerje	Në fund të periudhës raportuese
	€m	€m
Aksionet e zakonshme	60	60
Fitimet e mbajtura	94	126
	<u>154</u>	<u>186</u>
Korigjimet e vlerës së drejtë		
Toka dhe ndërtesat	20	20
Hulumtim dhe zhvillim	-	(12)
FPR në stoqe	<u>-</u>	<u>(3)</u>
	<b>174</b>	<b>191</b>

**L13 Zëri i mirë**

Konsiderata e paguar	168
Interesi jo-kontrollues	<u>42</u>
	210
Vlera e drejtë e neto pasurive të degës	<u>174</u>
Zëri i mirë	<b>36</b>
Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues në	
Daten e blerjes @ 3.50	42.00
Vlera e drejtë e pasurive 174 x 20%	<u>34.80</u>
Zëri i mirë i atribuar IJK-së	<b>7.20</b>

**L14 Interesi jo-kontrollues në fund të periudhës raportuese**

20% x €191 m	38.20
Zëri i mirë	<u>7.20</u>
	<b>45.40</b>

**L15 Fitimet e mbajtura**

Adam sh.a	222m
Pasuritë kontigjente	0.3m
Dega	
{(191 - 174) * 80%	<u>13.6m</u>
	<b>235.90</b>
Llogaritja alternative:	
126 - 94 = 32-3-12 = 17 x 80%	13.6m

**(b)**

Me qëllim të kontabilizimit të një blerje, kompania që blen duhet të masë koston e çfarë është duke kontabilizuar, që normalisht do të paraqes:

- Koston e investimit në pasqyrën e vet të pozitës, dhe
- Shumën e alokuar ndërmjet pasurive neto të identifikueshme të degës, interesit jo-kontrollues dhe zërit të mirë në pasqyrat e konsoliduara financiare.

Vlera e drejtë e definuar sipas SNRF 3 është 'shuma për të cilën një pasuri mund të këmbehet osë një detyrim të shlyhet ndërmjet palëve të mirë-informuara, dhe të vullnetshme në një transaksion duarlibër'.

Pasuritë dhe detyrimet e identifikueshme janë të përfshira në pasqyrat e konsoliduara sipas vlerës së drejtë sepse:

- Pasqyrat e konsoliduara janë nga prespektiva e grupit, e jo nga prespektiva e kompanive individuale. Kosto e grupit është vlera e tyre e drejtë në datën e blerjes.
- Zëri i mirë i blerë (sipas SNRF 3 të rishikuar) është diferenca ndërmjet vlerës së blerjes së entitetit dhe shumës së agreguar të vlerës së drejtë të pasurive dhe detyrimeve të identifikueshme të entitetit. Nëse vlera e drejtë nuk përdoret atëhere zëri i mirë nuk do të ketë kuptim.

## Problemi 2

Pasqyrat financiare të Greenspan sh.a janë si në vijim:

### Pasqyra e Pozitës Financiare

	Me 30 qershor	
	2017	2016
	€000	€000
<b>Pasuritë</b>		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika dhe paisjet	12,034	11,436
Pasuritë e paprekshme	1,240	1,304
Kreditë afatgjata dhe avanset	<u>682</u>	<u>979</u>
	13,956	13,719
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	917	589
Të arkëtueshmet tregtare	594	385
Avanset, depozitat dhe parapagimet	378	326
Investimet afatshkurtera	2,900	2,200
Paraja dhe saldot në bankë	<u>382</u>	<u>288</u>
	<u>5,171</u>	<u>3,788</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>19,127</b>	<b>17,507</b>
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>		
Aksionet e zakonshme €10 për aksion	12,540	11,400
Premia e aksioneve	378	150
Fitimet e mbajtura	<u>1,546</u>	<u>943</u>
	<b>14,464</b>	<b>12,493</b>
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
Kreditë afatgjata	3,284	3,891
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>		
Kreditë afatshkurtëra	82	101
Të pagueshmet, akrualet dhe detyrimet tjera	891	597
Mbitërheqja bankare	23	43
Provizionet për tatim	<u>383</u>	<u>382</u>
	<u>1,379</u>	<u>1,123</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>19,127</b>	<b>17,507</b>



**Pasqyra e të ardhurave për vitin e përfunduar me 30 qershor 2017**

	€ 000
Shitjet	16,213
Kosto e shitjes	<u>(10,900)</u>
<b>Fitimi bruto</b>	<b>5,313</b>
Shpenzimet administrative	(3,090)
Shpenzimet e shitjes	<u>(625)</u>
<b>Fitimi operativ</b>	<b>1,598</b>
Të hyrat nga interesi	343
Ngarkesat financiare	<u>(455)</u>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>1,486</b>
Tatimi në fitim	(340)
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>1,146</b>

**Informata shtesë:**

- (i) Zhvlerësimi i akumuluar duke përfshirë zhvlerësimin e këtij viti për tërë pronën, fabrikën dhe paisjet ishte €5,215,000 me 30 qershor 2016 dhe €6,895,000 me 30 qershor 2017.
- (ii) Fabrika dhe makineria që kushtoi €235,000 dhe që kishte vlerë në libra prej €143,000 u shit për €157,000 gjatë vitit 2017.
- (iii) Nuk kishte shtime apo largime të pasurive të paprekshme gjatë vitit.
- (iv) Avanset, depozitat dhe parapagimet përfshijnë interesin e arkëtueshëm në shumë prej €125,000 me 30 qershor 2016 dhe €150,000 me 30 qershor 2017.
- (v) Investimet afatshkurtera janë shumë likuide që kane një apo dy muaj maturitet.
- (vi) Kompania bëri një emetim të të drejtave prej 1 aksioni për çdo 10 aksione të mbajtura më herët me një premi prej 20% mbi vlerën nominale.
- (vii) Fitimet e mbajtura në pasqyrën e pozitës financiare janë pas pagesës së dividendës gjatë vitit nga fitimet e mbajtura të kompanisë.
- (viii) Ngarkesat financiare paraqesin interesin prej €452,000 në kredi dhe përfshijnë tarifa të zbritura nga banka në shumë prej € 3,000.
- (x) Të pagueshmet, akrualet dhe detyrimet tjera përfshijnë interesin e pagueshëm prej €80,000 dhe €75,000 me 30 qershor 2016 dhe 30 qershor 2017 respektivisht.

**Kërkohet:**

**Përgadite Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë për vitin e përfunduar me 30 qershor 2017 duke përdorur metodën indirekte në pajtim me SNK 7 Pasqyra e rrjedhës së parasë. (20 pikë)**

**(20 pikë)**

## Zgjidhja e Problemit 2

### Greenspan sh.a

#### Pasqyra e rrjedhës së arkës për vitin e përfunduar me 30 qershor 2017

€ 000

#### **Rrjedha e parasë nga aktivitete operacionale**

Fitimi para tatimit	1,486
Korigjimet për zërat jo-në para:	
Fitimi në shitjen e fabrikës (157-143)	(14)
Zhvlerësimi për vitin (L1 1)	1,772
Amortizimi i pasurive të paprekshme (1,304 - 1,240)	64
Të hyrat nga interesi	(343)
Ngarkesat financiare	<u>452</u>
<i>Rrjedhat e parasë nga operacionet para ndryshimeve në kapitalin qarkullues</i>	<b>3,417</b>
Rritja në stoqe (589 - 917)	(328)
Rritja në llogaritë e arkëtueshme (385 -594)	(209)
Rritja në avanset, depozitat dhe parapagimet (201 - 228)	(27)
Rritja në të pagueshmet, akrualet dhe detyrimet tjera (816 - 517)	<u>299</u>
<i>Rrjedhat e parasë nga operacionet</i>	<b>3,152</b>
Interesi i paguar (L1 5)	(457)
Tatimi i paguar (L1 3)	<u>(339)</u>
<b>Neto rrjedha e parasë nga aktivitete operacionale</b>	<b>2,356</b>

#### **Rrjedha e parasë nga aktivitete investuese**

Shitja e fabrikës dhe makinerisë	157
Blerja e fabrikës dhe makinerisë (L1 4)	(2,513)
Interesi i arkëtuar (L1 2)	318
Zvogëlimi i kredive afatgjata dhe avanseve (682 - 979)	<u>297</u>
<b>Neto rrjedha e parasë nga aktivitete investuese</b>	<b>(1,741)</b>

#### **Rrjedha e parasë nga aktivitete operacionale**

Emetimi i aksioneve (1,140 + 228) (L1 9 dhe L1 10)	1,368
Dividenda e paguar	(543)
Zvogëlim i borxheve afatgjata (3,284 - 3,891)	(607)
Ripagim i kredive afatshkurtëra (101 - 82)	<u>(19)</u>
<b>Neto rrjedha e parasë nga aktivitete operacionale</b>	<b>199</b>
<b>Rritja në para</b>	<b>814</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim</b>	<b>2,445</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund</b>	<b>3,259</b>

#### **Përbërësit e parasë në € 000**

	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Paraja dhe saldot në bankë	382	288
Investimet afatshkurtera	2,900	2,200
Mbitërheqja bankare	(23)	(43)

**L1.1 Zhvlerësimi**

Shitja (235,000 -143,000)	92,000	Në fillim	5,215,000
Në fund	<u>6,895,000</u>	Zhvlerësimi aktual	<u>1,772,000</u>
	<b>6,987,000</b>		<b>6,987,000</b>

**L1.2 Të hyrat nga interesi**

Në fillim	125,000	Paraja	318,000
PA	<u>343,000</u>	Në fund	<u>150,000</u>
	<b>468,000</b>		<b>468,000</b>

**L1.3 Tatimi i paguar**

Paraja	339,000	Në fillim	382,000
Në fund	<u>343,000</u>	PA	<u>150,000</u>
	<b>722,000</b>		<b>722,000</b>

**L1.4 Prona, fabrika dhe paisjet**

Në fillim	11,436,000	Shitur	143,000
Blerjet	<u>2,513,000</u>	Zhvlersimi	1,772,000
	<b>13,949,000</b>	Ne fund	<u>12,034,000</u>
			<b>13,949,000</b>

**L1.5 Interesi i pagueshem**

Paguar	457,000	Në fillim	80,000
Në fund	<u>75,000</u>	PA	<u>452,000</u>
	<b>532,000</b>		<b>532,000</b>

**L1.6 Fitimiet e mbajtura**

Dividenda	543,000	Në fillim	943,000
Në fund	<u>1,546,000</u>	PA	<u>1,146,000</u>
	<b>2,089,000</b>		<b>2,089,000</b>

**L1.7 Të pagueshmet, akrualet dhe detyrimet tjera**

Në fund	891,000	Në fillim	597,000
Minus: Interesi i pagueshem	<u>(75,000)</u>		<u>(80,000)</u>
	<b>816,000</b>		<b>517,000</b>

**L1.8 Avanset, depozitat dhe parapagimet**

Në fillim	378,000	Në fund	326,000
Minus: të hyrat nga interesi	<u>(150,000)</u>		<u>(125,000)</u>
	<b>228,000</b>		<b>201,000</b>

**L1.9 Kapitali aksionar**

		Në fillim	11,400,000
Në fund	<u>12,540,000</u>	Të drejtat (11,400,000 x 10%)	<u>1,140,000</u>
	<b>12,540,000</b>		<b>12,540,000</b>

**L1.10 Premia e aksioneve**

		Në fillim	150,000
Në fund	<u>378,000</u>	Të drejtat (11,400,000 x 20%)	<u>228,000</u>
	<b>378,000</b>		<b>378,000</b>

### Problemi 3

(a)

(i) Çfarë nënkuptoni më frazen elementet e pasqyrave financiare? Identifikoni elementet që kanë të bëjnë me Pasqyrën e të Ardhurave dhe Pasqyrën e Pozitës Financiare. (3 pikë)

(ii) Cilët janë kriteret për njohjen e një elementi në pasqyrat financiare? (2 pikë)

(b) Informatat në vijim kanë të bëjnë me një kontratë ndërtimi, e cila filloi me 1 korrik, 2014:

	€ 000
Shuma fillestare e dakorduar e të hyrave	2,000,000
Shuma fillestare e kostove	1,750,000
Vlerësimet e rishikuara e kostove me qershor 30, 2015	1,800,000
Ndryshime të tjera të akorduara gjatë 2015-2016:	
Të hyrat shtesë të dakorduara me klientin nga ndryshimet shtesë	200,000
Kostot shtesë të ndryshimit shtesë	150,000
Materialet më 30 qershor 2016 të vendosura në punishte për përdorim gjatë 2016-2017	10,000

Faza e kompletimit përcaktohet duke llogaritur proporcionin që kostot e punës së kontratës të shkaktuara deri në datën e caktuar përbëjnë në vlerësimet e fundit në po atë datë të kostove totale të kontratës. Kostot e shkaktuara që kanë të bëjnë me kontratën janë si në vijim:

	€ 000
Deri me 30 qershor 2015	750,000
Deri me 30 qershor 2016 (përfshirë materialet e vendosura në punishte)	1,525,000
Deri me 30 qershor 2017	1,950,000

Viti financiar përfundon me 30 qershor çdo vit.

**Kërkohet:**

**Kalkulo:**

- (i) Fazën e kompletimit në secilin vit të kontratës. (4 pikë)  
(ii) Të hyrat, kostot dhe fitimin të njohur për secilin vit të kontratës. (6 pikë)

- c) Miller sh.a ka importuar mallra gjatë vitit. Shpenzimet në vijim kanë të bëjnë me këto mallra:

	€
Shuma e faturës	200,000
Tarifat e importit dhe tatime tjera të pa-rimbursuara	65,000
Tarifa për transaksione	12,000
Kostot e punës gjatë transportit	5,000

Kompania mori një depo më qira për ti vendosur mallrat e importuara deri sa të shiten. Qiraja është €6,000 në vit. Shpenzimet e vlerësuara të shitjes janë € 15,000. Çmimi i shitjes i mallrave të importuara është €340,000. Për shkak të shiut në qytet mallrat janë dëmtuar. Vlera neto e realizueshme është vlerësuar të jetë €275,000.

**Kërkohet:**

- (i) Llogarite koston e mallrave pas importimit. (3 pikë)
- (ii) Trego shumën më të cilën stoqet do të paraqiten në Pasqyrën e Pozitës Financiare në pajtim me SNK 2 *Stoqet*. (2 pikë)

### Zgjidhja e Problemit 3

a)

(i) Pasqyrat financiare portretizojnë efektet financiare të transaksioneve dhe ngjarjeve tjera duke i grupuar ato në klasa të gjëra sipas karakteristikave të tyre ekonomike. Klasat e gjëra janë të emëruara elemente të pasqyrave financiare.

- Elementet që kanë të bëjnë direkt me gjendjen financiare në pasqyrën e pozitës financiare janë: pasuritë, detyrimet dhe ekuiteti
- Elementet që kanë të bëjnë direkt me performanën financiare në pasqyrën e të ardhurave janë: të hyrat dhe shpenzimet.

(ii) Një zë që e pëmbush përkufizimin e elementit duhet të njihet nëse:

- Është e mundshme që çfardo përfitimi ekonomik në të ardhmen që ka të bëjë me atë zë do të rrjedh në apo nga entiteti dhe
- Zëri ka kosto apo vlerë që mund të matet me besueshmëri

b)

	€ 000		
	2014-2015	2015-2016	2016-2017
Të hyrat e dakorduara në fillim	2,000,000	2,000,000	2,000,000
Ndryshimet		200,000	200,000
<b>Total të hyrat nga kontrata</b>	<b>2,000,000</b>	<b>2,200,000</b>	<b>2,200,000</b>
Kostot e shkaktuara deri më datë			
Për vitin aktual	750,000	1,515,000	1,950,000
Për vitin e ardhshëm	-	10,000	-
Kostot e kontratës për tu përfunduar	<u>1,050,000</u>	<u>425,000</u>	<u>-</u>
<b>Total kostot e vlerësuara</b>	<b>1,800,000</b>	<b>1,950,000</b>	<b>1,950,000</b>
Fitimi i vlerësuar	200,000	250,000	250,000
Faza e kompletimit	41.67%	77.69%	100%
Të hyrat	833,333	875,897	490,769
Kosto	<u>750,000</u>	<u>765,000</u>	<u>435,000</u>
<b>Fitimi</b>	<b>83,333</b>	<b>110,897</b>	<b>55,769</b>

c)

**(i) Kosto e mallrave pas transportiti**

	€
Shuma e faturës	200,000
Tarifat e importit dhe tatime tjera të pa-rimbursuara	65,000
Tarifa për transaksione	12,000
Kostot e punës gjatë transportit	<u>5,000</u>
<b>Total</b>	<b>282,000</b>

<b>(ii)</b> Total kosto e mallrave	282,000
Vlera neto e realizueshme	275,000

Vlera ne PPF është më e ulëta, pra €275,000

#### Problemi 4

- a) Me 1 janar 2012, Hayek sh.a bleu një franshizë të një kompanie të njohur të shërbimeve të dergesave në shtetin e Heartland. Pagoi tarifën fillestare të franshizës €5,000,000. Hayek sh.a pagoi gjithashtu tarifë për avokatët në shumë prej €150,000 lidhur me marrëveshjen e franshizës. Kompania gjithashtu pati shpenzime prej €50,000 dhe €100,000 lidhur me përpilimin e dokumentacionit dhe trajnimin e stafit respektivisht.

Liçenca e franshizës është dhënë për 10 vite dhe është e transferueshme. Kompania amortizon koston e liçencës së franshizës në baza drejtvizore.

Me 31 dhjetor 2016 vlera e tregut e liçences ishte €3,000,000 dhe ka një treg aktiv. Kompania vendosi të rivlerësoj liçencën e franshizës.

#### Kërkohet:

- a) **Llogarite koston e liçensës së franshizës në pajtim me kërkesat e SNK 38 Pasuritë e paprekshme (4 pikë)**
- b) **Përgaditi hyrjet në ditar për të regjistruar kostot e liçensës së franshizës dhe rivlerësimin e liçensës së franshizës (6 pikë)**
- (b) Pasqyra e Pozitës Financiare të Mill sh.a me date 30 qershor 2016 tregon kapitalin aksionar të zakonshëm të paguar prej €75 milion (€10 për aksion). Gjatë vitit të përfunduar me 30 qershor 2017 kompani emtoi opzione të 1.5 milion aksioneve Kompania raportoi neto fitim prej €1,350,000 për vitin e përfunduar me 30 qershor 2017. Çmimi i ushtrimit të opcioneve ishte €12 për aksion dhe vlera mesatare e tregut e aksioneve të zakonshme gjatë vitit 2017 ishte € 16 për aksion.

#### Kërkohet:

**Llogarite fitimin bazik për aksion dhe fitimin e tretur për aksion për vitin e përfunduar me 30 qershor 2017. (5 pikë)**



c) Samuelson sh.a përbëhet nga tri njësi gjeneruese të parasë. Pasuritë e njerës njësi gjeneruese të parasë përbëhen nga:

	<b>€ në miliona</b>
Prona, Fabrika dhe paisjet	26
Zëri i mirë	2
Patenta	1
Stoqet	<u>12</u>
	<b>41</b>

Më 31 dhjetor 2016, një ushtrim lidhur me vlerësimin e dëmtimit zbuloi që shuma e rikuperueshme e pasurive të njësisë gjeneruese të parasë është €35 milion.

Informatat në vijim janë relevante:

- Mallrat në vlerë prej € 1 milion janë shkatërruar nga zjarri
- Të drejtat e patentës nuk kanë vlerë të tregut
- Teprica e rivlerësimit e cila kishte një saldo kreditore prej € 1 milion me 1 janar 2015 paqarqet nje rivleresim mbi koston e pronës, fabrikës dhe paisjeve.

**Kërkohet:**

**Aloko humbjet nga dëmtimi tek pasuritë e përmenduarra më sipër.**

**(5 pikë)**

## Zgjidhja e Problemit 4

a)

(i)

	€
Tarifa e liçensës së franshisës:	
Tarifa e liçensës	5,000,000
Tarifa e avokatëve	150,000
Pagesat për dokumentacion	<u>50,000</u>
	<b>5,200,000</b>
Kostot vjetore të amortizimit (5,200,000 / 10)	520,000
Vlera e tregut e liçensës së franshizës	3,000,000
Minus: Vlera e bartëse e liçensës së franshizës Me 31 dhjetor 2016	
Kosto e liçensës së franshizës	5,200,000
Amortizimi gjatë viteve 2012-2016 (520,000 x 5)	<u>(2,600,000)</u>
	<u>2,600,000</u>
Teprica e rivlerësimit	<b>400,000</b>

(ii) Hayek sh.a

Data	Përshkrimi	Debi €	Kredi €
1 janar 2012	Pasuritë e paprekshme – Franshiza Banka <i>Regjistrimi i kostos së franshizës</i>	5,200,000	5,200,000
31 dhjetor 2016	Amortizimi i akumuluar Pasuritë e paprekshme – Franshiza Pasuritë e paprekshme – Franshiza Teprica e rivlerësimit <i>Regjistrimi i rivlerësimit</i>	2,600,000 400,000	2,600,000 400,000

b)

Fitimi bazik për aksiom = fitimi e atribuar aksionarve të zakonshëm/ numrin e aksionve të zakonshme

Fitimi bazik për aksiom = 1,350,000 / 7,500,000 = 0.18€ për aksion

Fitimi i tretur për aksion = 1,350,000 / ( 7,500,000 +1,500,000 -1,500,000 x 12/16)

Fitimi i tretur për aksion = 1,350,000 / ( 7,500,000 +375,000 )= 0.171 € për aksion

#### 4

##### (c) (i)

Kompania duhet t'i njohë dëmtimet si në vijim:

- (i) Ndonjë pasuri që është qartazi e dëmtuar apo shkatërruar. Humbja e €1 milion prej dëmtimit të stoqeve nga zjarri dhe vlerës së patentës duhet të alokohet së pari.
- (ii) Pastaj zëri i mirë prej € 2 milion duhet të shlyhet
- (iii) Pjesa e mbetur e humbjeve nga dëmtimi duhet të alokohet tek pasuritë jo-qarkulluese të prekshme

Pas alokimit të humbjeve nga dëmtimi, pasuritë e njesisë gjeneruese të parasë do të paraqiten si në vijim:

	<b>Vlera bartese pas dëmtimit</b>	<b>Humbja nga dëmtimi</b>	<b>€ në milion Vlera bartese pas dëmtimit</b>
Prona, Fabrika dhe paisjet	26	(2)	24
Zëri i mirë	2	(2)	-
Patenta	1	(1)	-
Stoqet	<u>12</u>	<u>(1)</u>	<u>11</u>
<b>Total</b>	<b>41</b>	<b>(6)</b>	<b>35</b>

## Problemi 5

Bilanci vertetues në vijim i takon Yunus sh.a me 30 shtator 2016:

	€'000	€'000
Të hyrat (shënim 1)		532,000
Stoqet me 1 tetor 2015	65,380	
Blerjet (shënim 2)	375,200	
Interesi në mbitërheqje	490	
Shpenzimet e shpërndarjes	19,880	
Kostot administrative (përfshitë dividenden e paguar prej €33.6 milion)	64,960	
Të hyrat nga investimet		1,120
Prona nën lizing sipas koston (shënim 2)	70,000	
Prona, Fabrika & Paisjet (shënim 2)	62,300	
Zhvlërësimi/amortizimi i akumuluar me 1 tetor 2015		
- Prona nën lizing		14,000
- Prona, Fabrika & Paisjet		20,300
Pasuritë financiare: Investimet në ekuitet (shënim 3)	25,200	
Aksionet e zakonshme prej €1		70,000
Fitimet e mbajtura me 1 tetor 2015		47,040
Tatimi i shtyrë (shënim 5)		3,780
Të arkëtueshmet tregtare	46,970	
Të pagueshmet tregtare		38,920
Banka		3,220
	<b>730,380</b>	<b>730,380</b>

Informatat në vijim janë vënë në dispozicion:

- i) Në të hyra janë përfshirë mallrat e shitura në shtator 2016 për €3.36 milion sipas marrëveshjes dy mujore me mundësi të kthimit nese nuk shiten nga bleresi (baza shite ose ktheje) dhe Yunus sh.a nuk është i sigurtë nëse ndonjë nga këto mallra do t'i kthehen brenda periudhës së lartëcekur. Një marzhë e fitimit bruto prej 25% në shitje është përdorur në këto mallra.
- ii) Gjatë vitit, Yunus sh.a e angazhoi një kontraktor lokal për të ndërtuar një fabrikë më kosto totale prej €95.2 milion. Kjo kosto është përfshirë në blerjet në bilancin vertetues. Fabrika e Yunus sh.a është përfunduar me 1 prill 2016 kur gjithashtu filloi prodhimin në shkallë të plotë dhe u dorëzua çertifikata e përfundimit nga kontraktuesi.

Të gjitha pronat, fabrikat dhe paisjet zhvlerësohen me 20% në vit duke përdorur metodën e saldoshme të zbritur me ndarje proporcionale kohore në vitin e blerjes/ndërtimit.

Me 1 tetor 2015, drejtorët e Yunus sh.a angazhoi një vlerësues të pavarur të çertifikuar për të vlerësuar pronën në lizing në pajtim me kushtet aktuale ekonomike. Prona u rivlerësua në €67.2 milion në këtë datë dhe u zhvlerësua përgjatë jetëgjatësisë fillestare prej 20 viteve e cila mbetet e pandryshuar. Injoro implikimet e tatimit të shtyrë.

Nuk është ngarkuar ndonjë zhvlerësim për pasuritë jo-qarkulluese në vitin aktual. Zhvlerësimi i ngarkohet koston së shitjeve.

- iii) Yunus kontabilizon instrumentet e ekuitetit sipas vleres së drejtë përmes fitimit ose humbjes në pajtim me SNK 39 *Instrumentet Financiare: Njohja dhe matja*. Instrumentet kishin vlerë të drejtë prej €24.36 milion me 30 shtator 2016. Nuk ka pasur as shitje e as blerje të instrumenteve të ekuitetit gjatë vitit.
- iv) Stoqet e Yunus sh.a në lokacionet e saj me 30 shtator 2016 u vlerësuan me kosto prej €76.72 milion
- v) Kërkoet një provizion për tatimin në fitim prej €34.02 milion për vitin e përfunduar me 30 shtator 2016. Për qëllime të tatimit të shtyrë neto pasuritë Yunus sh.a janë vlerësuar në €15 milion. Norma e tatimit në fitim të Yunus sh.a është 30%. Kjo nënkupton detyrim të tatimit të shtyrë prej 4.5 milion (15 milion x 30%).

**Kërkoet:**

**Përgaditi në pajtim më Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF):**

- (i) Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 30 shtator 2016. (12 pikë)
- (ii) Pasqyrën e Pozitës Financiare me 30 shtator 2016. (8 pikë)

[Total: 20 pikë]

## Zgjidhja e Problemit 5

(i)

Yunus sh.a

### Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 30 shtator 2016

	€'000
Të hyrat (532,000 - 3,360 mallrat sipas bazës shite ose ktheje)	528,640
Kosto e shitjes (LL.1)	<u>(288,260)</u>
<b>Fitimi bruto</b>	<b>240,380</b>
Shpenzimet e shpërndarjes	(19,880)
Kostot administrative (64,960 - 33,600 dividenda e paguar)	(31,360)
Të hyrat nga investimet	1,120
Humbja në vlerën e drejte të instrumenteve të ekuitetit (25,200 - 24,360)	(840)
Kosto financiare	<u>(490)</u>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>188,930</b>
Tatimi [34,020 + (4,500 - 3,780)]	<u>(34,740)</u>
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>154,190</b>
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	
Fitimi në rivlerësimin e pronës nën lizing (LL.4)	<u>11,200</u>
<b>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>165,390</b>

(ii)

Yunus sh.a

**Pasqyra e Pozitës Financiare me 30 shtator 2016**

<b>Pasuritë</b>	<b>€'000</b>
Pasuritë jo-qarkulluese	
Prona, Fabrika & Paisjet (Ll.4)	182,280
Pasuritë financiare: Instrumentet e ekuitetit	<u>24,360</u>
	206,640
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>	
Stoqet (Ll.2)	79,240
Të arkëtueshmet tregtare (46,970 - 3,360 sipas bazës shite ose ktheje)	<u>43,610</u>
<b>Total pasuritë</b>	<b>329,490</b>
<b>Ekuiteti dhe Detyrimet</b>	
Aksionet e ekuitetit prej €1 secila	70,000
Teprica e rivlerësimit Ll.4	10,500
Fitimet e mbajtura (47,040 + 154,190 - 33,600 div. e paguar + 700)	<u>168,330</u>
<b>Total ekuiteti</b>	<b>248,830</b>
<i>Detyrimet Afatgjata</i>	
Tatimi i shtyrë (15,000 x 30%)	4,500
<i>Detyrimet Afatshkurtëra</i>	
Të pagueshmet tregtare	38,920
Mbitërheqja bankare	3,220
Tatimi aktual i pagueshëm	<u>34,020</u>
<b>Total Ekuiteti dhe Detyrimet</b>	<b>329,490</b>

<i>Llogaritjet</i>	<b>€'000</b>
<b>1. Kosto e shitjes</b>	
Stoqet në fillim	65,380
Blerjet	375,200
Kostot e kapitalizara të fabrikës	(95,200)
Zhvlerësimi i pronës nën lizing	4,200
Zhvlerësimi i PFP (L13)	17,920
Stoqet në fund(L12)	<u>(79,240)</u>
	<b>288,260</b>
<b>2. Stoqet</b>	
Sipas numërimit	76,720
Shto: KMSH sipas shite ose ktheje (3,360 x 75%)	<u>2,520</u>
	79,240
<b>3. Zhvlerësimi</b>	
PFP e vjetër [(62,300 - 20,300) x 20%]	8,400
Prona e re [95,200 x 20% x ½ vite]	<u>9,520</u>
	17,920
<b>4. Pasuritë jo-qarkulluese sipas vlerës bartëse</b>	
Prona nën lizing (67,200 - 4,200)	63,000
PFP e vjetër (62,300 - 20,300 - 8,400)	33,600
Prona e re [95,200 - 9,520]	<u>85,680</u>
	182,280
Prona nën lizing para vlerësimit (70,000 - 14,000)	56,000
Shuma e rivlerësuar	<u>67,200</u>
Përfitimi nga vlerësimi tek rezerva e rivlerësimit	<b>11,200</b>

Zvlerësimi para rivlerësimit 70,000/20 vite = 3,500

Zvlerësimi pas rivlerësimit 67,200/16 vite = 4,200

Transferi nga rezervat e rivlerësimit tek fitimet e mbajtura 4,200-3,500 = 700